



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SHKOLLA 9-VJEÇARE YZBERISH



Nr:66 Prot

Tiranë, më 15 /04/2015

(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA NJOFTIM PËR VËND TË LIRË PUNE

Drejtorja e shkollës 9-vjeçare Yzberish ,Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69 / 2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “, të VKM Nr.66”, datë 03.02.2010 „ Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore „, si dhe të udhëzimit nr.58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit nga puna të nëndrejtorit të institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar“, shpall konkursin për vend të lirë pune në pozicionin **Nëndrejtor i Institucionit Arsimor Publik në :**

1.Shkollën 9-vjeçare Yzberish , Tiranë .

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

Kandidati/ja për nëndrejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

- a) Të ketë diplomë të nivelit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9741 , datë 21.05.2007 “ Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë , të ndryshuar (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe e listës së notave të shkollës së lartë).
- b)Të ketë të paktën kategorinë “mësues i kualifikuar “dhe në provimin e kualifikimit të jetë vlerësuar “ shumë mirë “ose “mirë”(fotokopje e noterizuar e dëshmisë së kualifikimit) .
- c)Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij (nëse nuk ka , e deklaron me shkrim që nuk ka) .

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati/ja për nëndrejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

a)CV-në dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë pohimet në CV (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.1,bashkëlidhur këtij udhëzimi).

b)Tabelën e plotësuar me të dhënat për aplikuesin(Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.2 , bashkëlidhur këtij udhëzimi).

c)Dëshminë e penaltetit të lëshuar jo më herët se tri muaj para datës së aplikimit .

ç)Deklaratën personale që vërteton se nëndrejtori nuk ka lidhje familjare me drejtorin e institucionit (bashkëshort/te ,prind , vëlla/motër , fëmijë në moshë madhore etj.)

d)Dy rekomandime nga mësues ose drejtorë të institucioneve arsimore ose titullarë të njësive arsimore vendore që kanë punuar me aplikantin gjatë viteve të fundit (Sipas modelit në shtojcën nr.3 , bashkëlidhur këtij udhëzimi).

Dokumentacioni i aplikimit ,i përcaktuar në pikën 1,dorëzohet në drejtorinë e institucionit arsimor publik.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 10 ditë pas shpalljes së kërkesës për nëndrejtor .

Konkurimi do të zhvillohet në ambjentet e shkollës 9-vjecare ,Yzberish, Tiranë në datën , 27.04.2015.

DREJTOR

Margarita KOROVESHI

